

PRANUAR MË
ACCEPTED ON 20/03/2025
PRIMLJEND
Nr.No. Nr. 02/32



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi Komunal Malishevë

Nr.02/____

Datë: 18.03.2025

Në bazë të nenit 8, nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17, nenit 24, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2, paragrafi 2.1, 2.3, të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 8, paragrafi 9 të Rregullores Nr.02/236 datë: 13.05.2022 për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, në bazë të nenit 13, nenit 23 paragrafi 7 shkronja (c), nenit 45, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -I- (parë) të rregullt të mbajtur me datë: 10.03.2025 merr këtë:

VENDIM

- Miratohet kërkesa nr.02/32 datë: 27.02.2025 e parashtruar nga _____ a fshati Carravranë Komuna e Malishevës për mbështetje financiare, për trajtim shëndetësor të djalit të saj _____
- Bazuar në pikën e 1 të këtij vendimi _____ nga fshati Carravranë i ndahen mjetet financiare në shumë prej 5,000.00 (pesë mijë euro), në emër të ndihmës momentale, për trajtim shëndetësor.
- Mjetet në shumë prej 5.000.00E (pesë mijë euro) ndahen nga kategoria e subvencioneve-blloku kodues 21/16013/200/00000/0111, zyra e kryetarit.
- Këtij vendimi i bashkangjiten: kërkesa dhe kopja e letërnjoftimit.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.06.2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës
Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi